



***Raport Hulumtues për të drejtat e
Grave në Pronë dhe Trashëgimi në
Komunën e Junikut***

Korrik 2017

Ky hulumtim u mundësua nga Programi Angazhimi për Barazi (E4E), i financuar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe përkrahur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të autorit –OJQ”JETA” dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e USAID apo ATRC.



PËRMBAJTJA:

1. Hyrje	4
2. Qëllimi i hulumtimit.....	4
3. Metodologjia e hulumtimit	5
4. Pyetësi dhe përmbajtja.....	5
5. Rezultatet e Hulumtimit në terren	5
6. Konkluzionet	19
7. Rekomandimet	20

Hyrje

Përkundër ekzistimit të një kornize të fuqishme ligjore (përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës) që garanton të drejtat e grave në pronësi dhe trashëgimi, sikurse në gjithë Kosovën ashtu edhe në komunën e Junikut gratë në realitet privohen nga kjo e drejtë meqë kjo çështje rregullohet sipas zakoneve dhe traditave ku vetëm trashëgimtarët meshkuj e ndajnë pasurinë në mënyrë të barabartë. Një vizitë e shkurtër në zyrën komunale për regjistrim të pronave të paluajtshme në Junik do tregonte ekzistimin e fare pak emrave të grave si pronare apo bashkëpronare të pronave. E në shumë raste, sidomos nëpër fshatrat e izoluar të komunës së Junikut kemi hasur në raste ku gratë/vajzat si fëmijë të vetëm dhe pa vëllëzër nuk e trashëgojnë pronën kur u vdesin prindërit respektivisht babai por e njejta pronë i ndahet të afërmeve tjerë meshkuj. Përmes këtij hulumtimi kemi fituar një pasqyrë më të qartë për problemin në fjalë, për njohuritë e grave/vajzave të komunës së Junikut për të drejtat e tyre pronësore/trashëgimore, problemet me të cilat ato ballafaqohen kur flitet për këtë çështje. Poashtu, përmes këtij raporti, kemi dhënë edhe rekomandimet tona akterëve vendimmarrës dhe politikëbërës të komunës për ndërmarrjen e masave konkrete për të parandaluar dhe luftuar këtë dukuri që vë gruan junikase në pozitë të pabarabartë me burrat kur flitet për të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgimore.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të identifikojë arsyet të cilat ndikojnë në mosshfrytëzimin e të drejtës së grave për të qenë titullare të pronës dhe për të trashëguar pronën ashtu që bazuar në këto gjetje të u rekomandojë autoriteteve komunale ndërmarrjen e masave adekuate për të adresuar këtë dukuri e cila e frenon barazinë e plotë të grave dhe burrave në komunën e Junikut. Përmes përgjigjeve të dhëna nga 500 respondente synohet të identifikohen vështërsitë dhe problemet me të cilat ballafaqohen ato kur është fjala mbi të drejtat e tyre në trashëgimi dhe pronë, ndërsa qëllimi kryesor mbetet vetëdijësimi i grave dhe burrave për të drejtat e barabarta të gruas në pronë dhe trashëgimi. Ndër objektivat tjera të këtij hulumtimi dhe tërë projektit në përgjithësi është vetëdijësimi i autoriteteve komunale për problemin në fjalë, ndikimi tek organet e drejtësisë që ti trajtojnë rastet e trashëgimisë së grave me një azhuritet më të madh dhe kursesi të mos lejojë dominimin e mëtejshëm të të drejtës zakonore-Kanunit që privon gruan të jetë pronare legjitime e pasurisë që trashëgohet nga prindërit apo – bashkëshortët. Ky projekt dhe ky hulumtim gjithashtu synon koordinimin më të mirë në mes të akterëve kryesorë sikurse janë autoritetet komunale, shoqëria civile, gjykatat, e sidomos mediat, detyra kryesore e të cilave është të alarmoj opinionin publik në Junik dhe rrethinë për ekzistimin e këtij problem që është duke u heshtur dhe neglizhuar me dekada të tëra.

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi është kryer me 500 respodente të moshës mbi 18 vjeçare të cilat janë identifikuar duke trokitur derë me derë në lagjet e Junikut ashtu dhe ne fshatrat përreth, respektivisht ne disa nga fshatrat e Komunes se Gjakoves që janë vizituar nga stafi i OJQ “Jeta”. Respodentet janë ndarë në katër grupe (të martuarat, të pamartuarat, gratë e veja dhe gratë që preferuan anonimitet) në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë të mendimeve dhe botëkuptimeve të gjeneratave të ndryshme të grave rreth kësaj teme. Gjatë intervistimeve nuk kemi hasur në asnjë hezitim të grave për tu përgjegjur në pyetjet e thjeshta të pyetësorit. Përkundrazi kemi pranuar përkrahjen e fuqishme dhe zotimin e tyre që të jenë pjesë e ligjëratave të ardhshme ku top-ekspertët do ligjërojnë për të drejtat e pakontestueshme të grave/vajzave të trashëgojnë pronën barabartë me burrat/djemtë.

Pyetësi dhe përmbajtja


Pyetësi përmbanë pyetje të cilat synojnë të paraqesin qëndrimet e grave dhe vajzave të komunës së Junikut për të drejtat e tyre në pronë dhe trashëgimi të pronës si dhe problemet e sfidat me të cilat ato ballafaqohen kur detyrohen të heqin dorë nga e drejta e tyre pronësore dhe trashëgimore në dobi të anëtarëve meshkuj të familjes. Pyetësi ka qenë i shkurtër dhe fare i thjeshtë, ashtu që grate e të gjitha moshave dhe niveleve arsimore të mund ta kuptojnë lehtë dhe t’i përgjigjen pyetjeve të parashtruara në kohë sa më të shkurtër. Ishin 500 respodente të cilat janë përzgjedhur rastësisht duke iu dhënë intervista të drejtëpërdrejta anketueseve nga OJQ “Jeta” të cilat zhvilluan intervistat gjatë tërë muajit Maj dhe Qershor 2017.

Rezultatet e Hulumtimit në terren

Janë intervistuar 500 gra dhe vajza të moshës madhore, të të gjitha niveleve arsimore, si dhe gra që jetojnë si në zonë urbane-qtet ashtu edhe ato që jetojnë në zona rurale-fshatra përreth. Përzgjedhja e grave/vajzave të anketuara është bërë rastësisht gjatë vizitave derë me derë nëpër lagjet e qytetit të Junikut dhe fshatrave të komunës së Gjakovës. Gjatë intervistimit të grave/vajzave nuk identifikua asnjë problem apo hezitim që të përgjigjen pyetjeve të pyetësorit dhe shumica dërmuese e respodenteve edhe u identifikuan edhe pse ato paten mundësinë edhe të konfidencialitetit, mundësi që u shfrytëzua nga afërsisht 18% e respodenteve apo saktësisht 72 që preferuan anonimitet të plotë.

Statusi i grave të anketuara - Nga të intervistuarat 224 apo (45%) janë të martuara 74 apo (15%) të veja 116 apo(23%) të pamartuara 3 apo (0.6%) bashkjetesë te shkurorëzuara 11 apo (2%) dhe 72 apo (15%) tjera që preferuan anonimitet dhe parapëlqyen të mos japin asnjë informatë në pyetjen e parë (emri, mbiemri, mosha, vendbanimi, statusi martesor).


Statusi martesor



GRAFIKONI 1. Statusi i grave të anketuara të paraqitur me përqindje


Vendbanimi i të anketuarve - Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kemi 280 (56%) të respondentëve janë nga Juniku 49 respondent apo (10%) nga Botusha 32 (6%) nga fshati Sheremet 18 apo (4%) nga fshati Dobrosh 15 apo (3%) nga fshati Nivokaz dhe 14 apo (3%) të anketuara nga fshati Molliq dhe 92 apo (18%) të të anketuarve janë anonim.

Vendbanimi i të anketuarve




GRAFIKONI 2. Paraqitja grafike dhe me përqindje dhe numer e vendbanimit të anketuarve

Mosha e të anketuarve - Nga grupi i grave të anketuara moshës prej 18-30 i përkasin 105 (21%) nga moshën 30-45 vjeçare i përkasin 165 (33%) prej moshës 45-60 vjeçare kemi 95 (19%) të anketuara, nga mosha 60 -81 vjeçar janë 61 (12.2%) gra dhe 74 (14.8%) kanë preferuar të jenë anonim dhe mos e tregojnë moshën e tyre.




GRAFIKONI 3. Grup mosha e të anketuarve e paraqitur me përqindje

Përgaditja shkollore e të anketuarve – Nga numri i përgjithshëm të anketuarat kanë këtë përgaditje shkollore si më poshtë. Me shkollim të lartë 142 apo (28%) me shkollim të mesëm 185 apo (37 %) te respondentëve, shkollim të ulët 143 apo (29 %) të anketuarve, pa shkollë 30 apo (6 %).




GRAFIKONI 4. Pergaditja shkollore e paraqitur me përqindje

A janë në dijeni gratë e komunës së Junikut për të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgimore” përgjigjet e tyre treguan dallimin evident në mes të gjeneratave të reja dhe atyre të vjetra sa i përket njohurive për të drejtat pronësore dhe trashëgimore. Nga numri i përgjithshëm i të intervistuarve tregon që 63 apo (13%) deklaruan të mos jenë në dijeni për këto të drejta. Këtë e pohuan grupi i grave të intervistuarra i grupmoshes 60-80 vjeçare ndërsa 433 (86%) thanë që janë në dijeni për të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgimore dhe 4 (0.8%) nuk dhanë përgjigje.



GRAFIKONI 5. Paraqitja me përqindje e njohurive të grave të Junikut për të drejtat e tyre pronësore dhe trashëgimore


A kanë gratë pronë (shtëpi, banesë, lokal, tokë) të regjistruar në emër të tyre Nga të intervistuarat e komunës së Junikut 143 (28.6%) deklaruan se kanë prona të regjistruara në emër të tyre (pytësi nuk kërkoi specifikim për llojin e pronës) ndërsa 357 (71.4%) të tjerat nuk kanë asnjë lloj prone në emër të tyre.



GRAFIKONI 6. A kanë gratë e komunës së Junikut pronë (shtëpi, banesë, lokal, tokë) të regjistruar në emër të tyre të paraqitura në përqindje

Në pyetjen a mendoni të shfrytëzoni të drejtën tuaj për të trashëguar pronë, gratë e intervistuarra deklaruan si vijon;

Nga pohimet të gjitha respondentëve të intervistuarra rezulton me 175 apo (35%) grave që i përgjigjën kësaj pyetje me JO kundrejt 325 (65%) të atyre që i thanë PO shfrytëzimit të së drejtës së tyre për të trashëguar pronë.



GRAFIKONI 7. Paraqitja me përqindje e opinionëve të grave që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të trashëguar pronë


Kush mendoni se do duhet të trashëgon pasurinë e prindërve djemt, vajzat, të dy gjinitë apo nuk e di, të anketuarat dhanë përgjigjet e mëposhtme: 91 preferuan që trashëgimia e prindërve të iu takojë vetëm fëmijëve meshkuj, 15 pohuan se pasurinë e prindërve do të duhej ta trashëgonin vajzat, 322 preferuan opsionin që gjithë fëmijët pa dallim gjinie do duhej të trashëgonin pasurinë e prindërve dhe 72 gra preferuan të mos deklarohen dhe zgjedhen opsionin nuk e di.

	Opsionet	Numri	Perqindja
1	Djemtë	91	18.2 %
2	Vajzat	15	3%
3	Të dy gjinitë	322	64,4%
4	Nuk e di	72	14.4%

TABELA 1. Paraqitja e opinjoneve në përqindje se kush duhet të trashëgon pasurinë e prindërve

A keni presion nga dikush të heqni dorë nga e drejta e trashëgimisë në të mirë të vëllaut (vëllëzërve) tuaj apo ndonjë të afërmi tuaj mashkull?” anketa jonë dha këto përgjegje:

Nga të anketuarat 27 dëshmuar të ekzistoj një presion mbi to në mënyrë që të heqin dorë nga e drejta e tyre trashëgimore dhe 473 i përgjigjën kësaj pyetje me JO.



GRAFIKONI 8. Paraqitur me përqindje opinionin e grave se a kanë presion nga dikush që të heqni dorë nga e drejta e trashëgimisë në të mirë të vëllaut (vëllëzërve) tuaj apo ndonjë të afërmi tuaj mashkull

Cili do të (mund) të ishte reagimi në rastet kur gruaja do të kërkonte pjesën e saj të trashëgimisë, ku pas intervistimit të grave respondentë në opsionet e dhëna kemi këto pohime si më poshtë: Ne opsionin e parë “do të pengohej nga pjesa tjetër e familjes (vëllezerit apo edhe të afërmit)” e perzgjedhen 61 respondentë, opsionin e dytë “do të kishte injorim nga të afërmit përfshirë familjen e saj” janë përgjigjur 3 gra, në opsionin tjetër, “do të kërcënohej nga familjarët,” kanë dhënë përgjigje 30 gra, në opsionin tjetër, “do të kishte pajtim të heshtur “janë përgjigjur 16 respondent, ne opsionin tjetër, “nuk do të kishte ndonjë pengesë “kemi numrin më të madh të respondentëve me 237 përgjigje në këtë opsion. Në opsionin tjetër “nuk e di” kemi 127 respondentë dhe në opsionin e fundit “pa përgjigje” dhe nuk dëshiruan të japin përgjigje kemi 26 respondentë.

Nr.	Opsionet	Nr i respondentëve	Përqindja
1	Do të pengohej nga pjesa tjetër e familjes(vëllezerit apo edhe të afërmit)	61	12.2%
2	Do të kishte injorim nga të afërmit përfshirë familjen e saj	3	0.6%
3	Do të kërcënohej nga familjarët	30	6%
4	Do të kishte pajtim të heshtur	16	3.2%
5	Nuk do të kishte ndonjë pengesë	237	47.4%
6	Nuk e di	127	25.4%
7	Pa përgjigje	26	5.2%

TABELA 2. Paraqitja me përqindje e mendimit se cili do të (mund) të ishte reagimi në rastet kur gruaja do të kërkonte pjesën e saj të trashëgimisë


A njihni ndonjë grua apo vajzë nga Komuna e Junikut e cila ka marrë trashëgimi nga prindërit e saj barabart me vëllzërit, nga të intervistuarat kemi 36 gra që thanë se njohin rastet kur fëmijët vajza të kenë trashëguar pronë nga prindërit barabart me fëmijët djem ndërsa 464 u përgjigjën me JO nuk njohin ndonjë vajzë të cilës i është ndarë pasuria e trashëguar nga prindërit në pjesë të barabarta me vëllzërit e saj.



GRAFIKONI 9. Paraqitja grafike me përqindje e numrit të grave që njohin dhe kanë marrë trashëgimi nga prindërit e sajë barabart me vëllzërit


Cilat janë pengesat sipas jush që pamundësojnë realizimin e të drejtave të grave të trashëgojnë pronën barabart me meshkujt në komunën tuaj” ku respondentet kanë mund të përzgjedhin a) zakonet/kanuni, b) fenë, c) mosarsimimi i femrës, d) moszbatimi i ligjit dhe c) zvarritja e procedurave nëpër gjykata, respondentet e anketuara identifikuan këto pengesa:

Nga numri i përgjithshëm 321 votuan zakonet/kanunin si pengesë kryesore, 178 mosarsimimin e gruas, në këto dy opsione kemi një numër prej 38 pjesemarrësve që kanë përzgjedhe të dy këto opsione, 5 fenë, 12 mosimplementimin e ligjit dhe 22 pohojne se një nga pengesat e mundeshme mund të jetë edhe zvarritja e procedurave nëpër gjykata.




GRAFIKONI 10. Paraqitja grafike e pengesave që pamundësojnë realizimin e të drejtave të grave të trashëgojnë pronën barabart me meshkujt në komunën tuaj

Nëse trashëgimtari i vetëm në familjen tuaj të ngushtë është vajzë si do të vepronit, ku respondentet kanë mundur të përzgjedhin opsionet 1. Do i jepja gjithë pasurinë vajzës time, kanë pohuar 311 responente, 2. Do i jepja gjithë pasurinë djemve të vllaut kanë pohuar 20 responente, 3. Nuk e di janë përgjigjur 123 responente, dhe 46 responente kane preferuar të mos përgjigjen fare.




A mendoni se ligjëratat për të drejtat trashëgimore të grave do të mund të ishin përfituese për to, kemi këto opinjone: 496 responente (99%) u përgjegjën me PO dhe vetëm 4 (1%) nga responentet përzgjedhën JO.



GRAFIKONI 12. Opinjonet e grave të paraqitura me përqindje rreth perfitimeve nga pjesemarrja në ligjëratave për të drejtat trashëgimore të grave

A do të merrnit ju personalisht pjesë në ligjeratat që do të mbahen, kemi: 427 apo (99%) e respodenteve u përgjegjën me PO dhe 73 apo (15%) e respodenteve të cilat përzgjedhën JO



GRAFIKONI 13. Paraqitja me përqindje e dëshires së grave të marrin pjesë në ligjeratat që do të mbahen në muajt në vazhdim

Konkluzionet

- Përkundër ekzistimit të infrastrukturës ligjore, zbatimi i mirëfilltë i të drejtave të grave në pronë dhe trashëgimi në komunën e Junikut është larg të dëshiruarës për të mos thënë inekzistent meqë e drejta zakonore, feja, mosarsimimi i gruas, mosimplementimi i ligjit dhe zvarritja e procedurave gjyqësore pamundësojnë një gjë të tillë e sidomos kanuni dhe feja të cilat janë thellë të rrënjosura dhe dominojnë në zbatimin praktik ashtu sikurse edhe përgjigjet e respondentëve të anketuara e dëshmojnë. Prandaj nga 500 gratë e anketuara, 85% prej tyre kanë njohuri dhe kanë dëgjuar për ligjet për trashëgiminë dhe të drejtat pronësore dhe mendojnë se edhe pse legjislacioni aktual në Kosovë njihet barazinë e plotë gjinore në trashëgimi, në praktikë kjo nuk gjen zbatimin adekuat meqë rregullohet sipas traditës dhe zakoneve si dhe dogmave fetare;
- Përkundër legjislacionit aktual që njihet barazinë e plotë të grave në trashëgimi, ndaj grave dhe vajzave të komunës së Junikut akoma përdoret presioni si formë e kërcenimit për të hequr dorë nga e drejta e trashëgimise në të mirë të vllaut apo të afërmeve të tyre të gjinisë mashkullore.
- Ndër problemet tjera që ky hulumtim identifikoi janë edhe vonesat dhe zvarritja e lëndëve të trashëgimisë si dhe hezitimi i organeve gjyqësore për të ekzekutuar vendimet, gjë kjo që i demotivon gratë dhe vajzat të kërkojnë të drejtën e tyre pronësore dhe trashëgimore;
- Ndër problemet evidente që kemi hasur gjatë intervistimit është edhe regjistrimi i pronësisë vetëm në emër të bashkëshortit gjë kjo e cila e vë në pozitë të pabarabart gruan e cila në të ardhmen do mund të përballet me sfida të ndryshme sikurse janë vdekja e bashkëshortit, shkurorëzimi;
- Mosarsimimi i grave është identifikuar si një ndër problemet kryesore që privojnë gruan të jetë bartëse e pronës apo të trashëgojë pronën nga prindërit/bashkëshorti barabartë me meshkujt. Në këtë aspekt, rolë domethënës kanë edhe vështërsitë financiare, mungesa e pavarësisë ekonomike të gruas, papunësia;
- Hulumtimi gjithashtu ka identifikuar edhe presionin nga familjarët tek gratë/vajzat që të mos e shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të qenë titullare të pronës apo trashëgimtare të barabarta me meshkujt, duke përdorur pengimin, **injorimin apo perjashtimin nga familja**.
- Ndryshimet e botëkuptimeve tradicionale rreth kësaj çështje do të mund të fillonin vetëm nëse ato vijnë nga baza-familjet tona prandaj është jetësore ngritja e nivelit të vetëdijësisë rreth këtij problemi, edukimi, avokimit etj.

Rekomandimet

- Autoritetet komunale do duhej të intensifikonin përpjekjet që përmes fushatave të ndryshme mediale (TV dhe radio emisioneve, broshurave informative) takimeve, iniciativave nga gratë asambleiste, të sensibilizojnë opinionin publik dhe ngrisin vetëdijen e grave dhe burrave për të drejtat pronësore/trashëgimore të grave/vajzave;
- Autoritetet komunale bashkërisht me autoritetet gjyqësore të komunës do duhej të fillonin me nisma konkrete dhe domethënëse që me të gjitha mjetet ligjore të luftojnë dominimin në praktikë të së drejtës zakonore dhe traditave fetare;
- Krerët e institucioneve gjyqësore dhe organeve policore duhet të mendojnë për parandalimin e praktikave aktuale kur gruaja/vajza detyrohet/kërcënohet nga familjarët të heqë dorë nga e drejta e saj pronësore/trashëgimore në dobi të familjarëve tjerë meshkuj;
- Në zyrën komunale për regjistrim të pronësisë të insistohet në respektimin e plotë të ligjit që parashikon regjistrimin e pronësisë së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve;
- Përmes koordinimit të autoriteteve komunale dhe institucioneve gjyqësore të krijohet një këshill/trup ndihmë-dhënës/konsultativ që do të iu mundësonte grave/vajzave të komunës së Junikut të kërkonin këshilla juridike falas rreth të drejtave të tyre pronësore dhe trashëgimore;
- Të krijohet një trup i përbërë nga ekspertët e kësaj fushe dhe bashkërisht me kompetentët arsimorë të komunës së Junik-ut të fillojnë me ligjërata javore nëpër të gjitha shkollat e arsimit të ulët dhe të mesëm të kësaj komune për të drejtën ligjore që iu takon grave/vajzave të jenë trashëgimtare të barabarta të pronës;
- Nën menaxhimin dhe financimin e autoriteteve komunale të krijohet një trup apo qendër që do bashkojë në gjirin e vetë të gjitha OJQ-të lokale, mediat, shoqatat e grave, shoqatat e gjykatësve/prokurorëve etj, ku në takime të rregullta mujore do bëhej koordinimi dhe planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta, monitorimi i punës së gjykatave në rastet e shqyrtimit të kontesteve gjyqësore/pronësore ku gruaja është palë si dhe të monitorohet zbatimi i plotë i ligjeve dhe të drejtave të grave dhe vajzave që të jenë titullare dhe trashëgimtare të pronës;
- Autoritetet komunale me ndihmën e autoriteteve qendrore të ngrisin një fond financiar i cili do u dedikohet OJQ-ve dhe shoqatave të grave në komunën e Junikut me qëllim të vetëdijësimit të grave dhe sensibilizimit të burrave rreth nevojës së barazisë së plotë të gruas në të gjitha fushat e jetës e sidomos të drejtës së gruas në pronësi dhe trashëgimi.